



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 367, Datë 15.12.2023

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 206, DATË
16.12.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A.”
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 13 pika 1, 16 pika 2, 17 gërma “e” dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2232/2 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi lënie në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të Gazit Natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.” për vitin 2024”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 326, datë 14.12.2022, vendosi ndër të tjera: *shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2023, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a.”.*
- ERE me shkresën nr. 2232 prot., datë 03.10.2023, i ka sjellë në vëmendje shoqërisë “Albgaz” sh.a., të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se gjashtë muaj para hyrjes së tyre në fuqi. Kërkesë e cila duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin sipas metodologjisë përkatëse.
- Shoqëria Albgaz sh.a., në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr. 118/1 prot., datë 07.11.2023, thekson se rrethanat në të cilat shoqëria “Albgaz” sh.a., zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si OST e gazit natyror, nuk ka patur zhvillime domethënëse të cilat do të ndikonin drejtpërdrejtë në elementet të cilët përcaktojnë metodologjinë e tarifës. Shoqëria “Albgaz” sh.a., kërkon që për vitin 2024 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit e miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 326, datë 14.12.2022.

- Neni 17, gërma “e”, e ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, parashikon se: *ERE, mund të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rast kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.*
- Duke patur parasysh se bordi i ERE-s me vendimin nr. 293, datë 23.10.2023 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria “Albagaz” sh.a., që përmban investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë si dhe vlerësohet se deri në momentin e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë për miratimin e një tarife transmetimi të gazit natyror sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike e vendimit të bordit të ERE-s nr. 206 datë 16.12.2019. Për arsye se tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria “Albgaz” sh.a., konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI